

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.H, V.B, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, dhe A.M, N.F, për shkak të veprës penale, Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore DKR në Prishtinë, të mbrojtëseve të akuzuarve, av. T.B, av.D.Rdhe av.A.K, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.341/2013, të dt.01.12.2015, në seancën e Kolegjit të mbajtur me dt. 02.06.2016, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesave të PTH-DKR në Prishtinë, dhe të mbrojtësve të akuzuarve, A.H, av. T.B, V.B, av.D.Rdhe A.M, av.A.K, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.341/2013, të dt.01.12.2015, anulohet dhe çështja penale kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

II. Përkitazi me ankesat e PTH DKR në Prishtinë dhe të mbrojtësve të akuzuarve, A.H, V.B, dhe A.M, e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.341/2013, të dt.01.12.2015, ndryshohet ashtu që ndaj të akuzuarit A.H, refuzohet akuza, për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin II/1, konform dispozitës së nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPP, lidhur me nenin 107 par.1 dhe 8 të KPRK, për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.341/2013, të dt.01.12.2015, të akuzuarit A.H, V.B, janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, dhe i gjykon të akuzuarin A.H dhe V.B, secilin veç e veç me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10(dhjetë) muaj, të cilin dënim nuk do ta mbaj po që se në afat prej 2(dy) vite, nuk kryen vepër tjetër penale. Të akuzuarin A.M, nga Prishtina, e shpall fajtor dhe e gjykon për veprën penale Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, dhe ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muaj, të cilin dënim do e mbaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari A.M, obligohet që në emër të kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit, "MKRS", ti paguaj shumën prej 5.871,13 Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohen të akuzuarit të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në mënyrë solidare, ndërsa në emër të paushallit të paguajnë shumën prej 100(njëqind) Euro, secili veç e veç në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 364 par.1 të KPRK, të akuzuarit A.H dhe N.F, lirohen nga akuza, në mungesë të provave.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesa:

- Prokuroria Themelore DKR, në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tersi ankesën e parashtruar, sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit ta ndryshoj dhe të akuzuarve A.H dhe N.F, t'iu shqiptoj dënim sipas dispozitave të parapara në KPRK, për veprat penale të cekura në aktgjykim, ndërsa të akuzuarve A.H, V.B dhe A.M, për veprat penale të cekura si në dispozitiv të aktgjykimit, t'ju shqiptoj dënim më të lartë ose çështjen ta kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit, A.H, av.T.B, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar në pikën I/1, ta refuzoj aktakuzën pasi që ka kaluar afati i parashkrimit apo ta ndryshoj duke e liruar nga akuza të akuzuarin A, apo çështjen penale ta kthej në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit V.B, av.D.R, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal në dëm të akuzuarit, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim, që Gjykata e Apelit, ankesën ta miratoj dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin V.B ta liroj nga akuza, ose aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe vendim.

- Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.A.K, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovet ankesa dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet, ashtu që të akuzuarin A.M, për shkak të mungesës së provave të lirohet nga vepra penale për të cilat është akuzuar, ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim.

-Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.236/2016, të dt.03.05.2016, ka propozuar që: I. Të aprovet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore DKR në Prishtinë, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë PKR.nr.341/13, dhe aktgjykimi i ankimuar sa i përket pjesës gjyquese për të akuzuarit A.H, V.B, të ndryshohet dhe në vend të dënimeve të kushtëzuara t'iu shqiptohen dënim me burg efektiv, të akuzuarit A.M, ti shqiptohet një dënim më i lartë me burg efektiv, ndërsa sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit për të akuzuarit A.H dhe N.F, aktgjykimi të ndryshohet dhe të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të gjykoen sipas ligjit, ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim.

II. Të refuzohet ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.H, av.T.B, V.B, av.Destan Rukiqi, dhe A.M, av.A.K, si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP të Kosovës, caktoj seancën e kolegjit me dt. 02.06.2016, ku morën pjesë i akuzuari A.H, i akuzuari V.B dhe mbrojtësi i tij av.D. R, i akuzuari A.M dhe mbrojtësi i tij av.A.K, me autorizim zëvendësues, për mbrojtësin e të akuzuarit

N.F , av.Osman Havolli, av. Sarandë Beqiri, ndërsa munguan, Prokurori i Apelit DKR në Prishtinë, mbrojtësi i të akuzuarit A.H, av. T.B, i akuzuari N.F, edhe pse ishin njoftuar në mënyrë të rregullt seanca u mbajte në mungesë të tyre, për arsye se pjesëmarrja nuk është e obliguar.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesave të PTH – DKR në Prishtinë dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, A.H, av.T.B, V.B, av. D.R dhe A.M, av.A.K, edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së, vlerësoji pretendimet ankimore të paraqitura në ankesa, duke marrë parasysh edhe mendimin e Prokurorisë së Apelit – DKR në Prishtinë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe gjeti :

Se ankesat e PTH – DKR në Prishtinë dhe të mbrojtësve të akuzuarve A.H, V.B, dhe A.M, janë të bazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore DKR në Prishtinë, në ankesën e saj pretendon, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike për të akuzuarin N.F, për veprën penale Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, dhe të akuzuarin A.H, për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, të cilët i liron nga akuza, po ashtu gjykata e shkallës së parë për veprat penale për të cilët të akuzuarit A.H, V.B, dhe A.M, me rastin e marrjes së vendimit lidhur me dënimin, nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, siç janë pesha e veprës penale, përgjegjësia penale e të akuzuarve, por ka marr parasysh vetëm rrethanat lehtësuese, dhe me dënimet e këtilla të shqiptuara nuk do të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H, av.T.B, në ankesën e tij pretendon se dispozitivi i aktgjykimit në pjesën e atakuar për të akuzuarin A.H, është i pa çart dhe në kundërtënieje me vetveten dhe arsyetimin, dhe me asnjë fakt apo provë të paraqitur në shqyrtimin gjyqësor, nuk është vërtetuar drejt se cilat kompetenca, i akuzuari i ka tejkaluar, apo detyra zyrtare nuk i ka përmbushur, dhe me të cilat prova është vërtetuar qëllimi i përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, andaj konsideroj se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike, e si pasojë e kësaj edhe vendimit mbi dënimin është i pa drejtë.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.B, av. D.R, në ankesën e tij pretendon, se në aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban fakte dhe prova konkrete që përbëjnë figurën e veprës penale, dhe se është bërë ri cilësimi i veprës penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK, në veprën Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, e prokurori pa e ndryshuar asnjë fjalë në përshkrimin faktik. Faktet përfundimtare të paraqitura në aktgjykim janë në kundërshtim me vetveten në vet aktgjykimin gjykues e sidomos në raport me aktgjykimin lirues. Ankesa pretendon se i akuzuari A.M, ka prezantuar llogari të rreme MRKS me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, e i cili veprim i të akuzuarit në përshkrimin faktik është i mangët dhe nuk ekziston lidhja në mes veprës penale me të cilën është shpallur fajtorë i akuzuari V.B, me veprën penale me të cilën është shpallur fajtor A.M. Gjykata nuk ka vërtetuar se si është kryer vepra penale, nuk është përshkruar qëllimi (dashja),e gjë që është në kundërshtim në raport me pjesën liruese ku i akuzuari N.F, lirohet me të cilën gjykata konstatoi se filmi e realizoi me vonës, ndërsa tejkallimet e afateve nuk parashihen me asnjë dispozitë ligjore. Gjykata nuk jep saktësinë e provave të dëshmitarëve K.G, dhe K.B, dhe gjendja faktike vërtetohet në kundërshtim me dispozitën e nenit 361 par.2 të KPP. Dhe gjykata edhe përkundër ekspertizës financiare konstaton përfitimin prej 100.000,00 Euro, e sipas ekspertizës rezulton se nuk janë të arsyetuara vetëm 5.871,13 Euro,. Si pasojë e

këtyre shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për arsye se aktgjykimi është në kundërshtim me nenin 365 par.1 për arsye se nuk i përmban elementet e një aktgjykimi ajo është në kundërshtim edhe me nenin 370 të KPP, dhe si pasojë e këtyre shkeljeve edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, pa vlerësimin e drejtë të kontratës dhe aneks kontratës për realizimin e filmit "...", në të cilën janë paraparë rregullat e realizimit të subvencionimit të filmit dhe nga ekspertiza e ekspertit financiar çart del se është krijuar raporti juridiko-civil ndërmjet MKRS dhe kompanisë "Morina Films".

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.A.K, në ankesën e tij pretendon, se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par 1.12 lidhur me nenin 370mpar 6 dhe 7 të KPP, kjo për arsye se gjykata nuk ka dhënë arsye për çdo pikë të akuzës dhe nuk i ka vlerësuar provat siç parasheh dispozita e nenit 370 par.7 të KPP. Dispozitivi është i pa qartë për arsye se nuk përmendet asnjë provë e vetme se cilat llogari të rreme i ka paraqitur i akuzuari A.M, gjë që e bënë në kundërshtim dispozitivin me arsyetimin. Në dispozitivin e aktgjykimit i akuzuari A.M ka përfituar shumë prej 100.000.,00 Euro, ndërsa dëmi i shkaktuar MKRS është 5.871,13 Euro, dhe përfitimi i kundërligjshëm nuk korrespondon me ekspertizën e ekspertit financiar dhe gjykata nuk bënë dallimin mes llogarive të rreme dhe shpenzimeve jo racionale, dhe për këtë gjykata nuk jep asnjë arsye lidhur me llogarit e paraqitura të rreme edhe për kundër asaj se eksperti financiar në asnjë pikë të ekspertizës së tij nuk përmend llogari të rreme të paraqitura nga i akuzuari A.M e në emër të kompanisë "Morina Films", dhe i akuzuari A, si producent ka arsyetuar subvencionimet e fazës së parë të filmit në shumë prej 94.128,87 Euro. Të gjitha këto nuk janë vlerësuar edhe me nënshkrimin e kontratës dhe aneks kontratës nga ana i të akuzuarit A.M. Po ashtu gjykata nuk ka ftuar ekspertin e kinematografisë e cila do të vërtetonte saktë se cilat janë fazat e realizimit të një projekti filmik. Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.M, pretendon se i akuzuari A.M, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë nuk e ka cilësinë e personit zyrtar, kjo për arsye se nuk ushtron funksion publik, ndërsa në organizatë biznesi nuk ka ushtruar autoritet publik, si pasojë e shkeljeve të cekura më lartë edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë kjo për arsye se të gjitha mjetet janë shpenzuar në mënyrë racionale dhe në përputhje të asaj që të realizoj filmin "...", gjë që mbështetet edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar, e kjo mbështetet edhe në atë se për realizimin e filmit "...", ka pas producent të mirënjohur të karakterit ndërkombëtar, dhe se shpenzimet të cilat janë bërë, janë bërë për fazën përgatitore e për të filluar realizimin e filmit , e për të cilën është lidhur edhe kontrata edhe aneks kontrata me MKRS.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesave të paraqitura të PTH DKR në Prishtinë, të mbrojtësve të akuzuarve A.H, V.B dhe A.M, e duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, rreth ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo gjykatë gjen se dispozitivet e aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, janë të pakuptueshme, në kundërshtim në arsyet e paraqitura dhe në aktgjykim nuk janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare dhe ekzistojnë kundërshtime ndërmjet asaj që paraqitet në përmbajtjen e aktgjykimit lidhur me shkresat dhe procesverbaleve, dhe deklarimeve të dhëna në procedurë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është përpiluar në kundërshtim me dispozitën e nenit 365 par.1 të KPP, për arsye se i tërë aktgjykimi është përshkrim i procesverbaleve të shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura dhe gjykata vepron në kundërshtim me nenin 370 par. 6 dhe 7, të KPP, dhe nuk jep arsye të qarta për çdo pikë të akuzës dhe nuk i vlerëson provat, siç parasheh dispozita e nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP, që aktgjykimi të mbështetet në faktet dhe provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësorë , dhe gjykata nuk e kryen obligimin e saj ligjorë që detyrimisht të vlerësoj çdo provë të nxjerr në shqyrtimin gjyqësor e në lidhshmëri me provat tjera e me qëllim të nxjerrjes së përfundimeve të sakta lidhur me faktet vendimtare si për pjesën gjyqësore dhe liruese të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, për vepra penale të njëjta, dhe për çështje të njëjta për të akuzuar të njëjta A.H dhe V.B, në cilësinë e ministrave në MKRS, si persona zyrtar, një njëerën anë,

ndërsa të akuzuarit A.M dhe N.F si pronar të kompanive “Morina Films”, dhe “ Concordia Pictures”, në anën tjetër dhe për baza të njëjta, merr dy vendime në kundërshtim me njëra tjetrën ashtu që të akuzuarve A.H dhe V.B, për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, për kontratën e lidhur në mes të MKRS të cilën e ka përfaqësuar i akuzuari A.H, e lidhur me dt.30.01.2007, dhe të aneks kontratës të lidhur në mes të MKRS të cilën e ka përfaqësuar V.B, e lidhur me dt.19.09.2008, e të cilat janë lidhur me pronarin e kompanisë “Morina Films” të cilën e ka përfaqësuar i akuzuari A.M, për realizimin e filmit të metrazhit të gjatë “...”, gjykata të akuzuarin A.H dhe V.B i shpall fajtorë, veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, ndërsa të akuzuarin A.M, e shpall fajtorë për veprën penale Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, ndërsa në anën tjetër MKRS të cilën e ka përfaqësuar i akuzuari A.H, lidhë kontratë me dt. 27.06.2006, me kompaninë “Concordia Pictures”, të cilën e ka përfaqësuar i akuzuari N.F, për realizimin e filmit “Power Cuts”, për subvencionimin e filmit prej 220.000,00 Euro, dhe gjykata të akuzuarin A.H për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, dhe të akuzuarin N.F për veprën penale Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPRK, në bazë të kontratave për subvencionimin e filmave të cekura më lartë dhe në prova të njëjta, merr aktgjykim lirues për të akuzuarit A.H dhe N.F, në kuptim të dispozitës së nenit 364 par.1 të KPP, se vepra penale për të cilën kanë qenë të akuzuar të akuzuarit A.H dhe N.F, nuk përbën vepër penale.

Nga kjo rezulton qarte se gjykata e shkallës së parë, për çështjet e njëjta për subvencionimin e filmave të kompanive të ndryshme, me objekt të njëjtë të kontratave, dhe me përkrahjen e dy Qeverive të Kosovës, me të cilat kanë udhëheqë në cilësinë e kryeministrave Bajram Kosumi dhe Agim Çeku, gjykata merr vendime të ndryshme, aktgjykim dënues për të akuzuarit A.H, dhe V.B si persona zyrtar, dhe të akuzuarin A.M si pronar i kompanis filmike “Morina Films”, ndërsa për çështjen e njëjte e me kompani tjetër filmike “ Concordia Pictures”, merr aktgjykim lirues për të akuzuarin A.H dhe N.F.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nga ajo që u cek më lartë gjykata e shkallës së parë për çështje të njëjta me ministrat të njëjtë, të akuzuarve A.H dhe V.B, e me kompani të ndryshme filmike, “Morina Films” dhe “Concordia Pictures”, e të cilat përfaqësohen nga të akuzuarit A.M dhe N.F, e të cilat kontrata kanë objekt të njëjtë subvencionimin e filmave, gjykata përdorë dy lloj vlerësimesh dhe për çështjet e njëjta i merr dy aktgjykime me kundërshtim me njëra tjetrën të cilat janë cekur më lartë, gjë që aktgjykimin dhe dispozitivet e përkrahura në të i bënë të pa çarta të pa kuptueshme dhe nuk jep arsye të qarta lidhur me faktet vendimtare për pjesën liruese dhe për pjesën gjykuese të aktgjykimimit.

Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë edhe për pjesën liruese e sidomos për pjesën gjykuese të aktgjykimimit nuk jep fakte dhe rrethana që e përbëjnë figurën e veprës penale, dhe nuk jep asnjë arsye lidhur me faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse ligjore, e kjo sidomos në aktgjykimin dënues me të cilën të akuzuarit e cekur më lartë janë shpallur fajtorë, e gjykata duke mos dhënë asnjë vlerësim në kuptim të nenit 370 par. 6 dhe 7 të KPP, lidhur me paraqitjen e drejtë dhe të plotë të fakteve lidhur me dy vendimet e cekura më lartë.

Gjykata e shkallës së parë, nuk jep asnjë arsye se cilat ishin prezantimet e rreme, të akuzuarit A.M, për veprën penale Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, kjo për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari ka prezantuar të gjithë dokumentacionin komplet për përgatitjen e filmit “...”, e cila mbështetet edhe me ekspertizën e ekspertit financiar Dr. R.B, ku rezulton se i akuzuari A.M, si producent i kompanisë “Morina Films”, ka arsyetuar shpenzimet prej 94.128,87 Euro, ndërsa si të pa arsyetuar ka mbetur shuma pre 5.871,13 Euro, e në kontest të kësaj, nëse i akuzuari Armon Morina ka paraqitur dhe ka prezantuar llogari të rreme, e cila sipas

ekspertizës nuk qëndron, gjykata e shkallës së parë nuk jep asnjë fakt se si të akuzuarit A.H dhe V.B kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, kjo për arsye se dispozitivet për të akuzuarit A.H dhe V.B, me përshkrimin e dispozitivit për të akuzuarin A.M, nuk mund të qëndrojnë me njëra tjetrën, dhe gjykata nuk jep asnjë fakt vendimtarë se në bazë të cilave fakte të akuzuarit A.H dhe V.B i shpalli fajtorë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në çështjen penale të akuzuarve A.H dhe N.F, merr aktgjykim lirues e në bazë të nenit 364 par.1 të KPP, për arsye se veprat penale të cilat janë cekur më lartë nuk përbëjnë vepër penale.

Në anën tjetër gjykata e shkallës së parë, nuk jep asnjë fakt vendimtarë në çështjen penale e të akuzuarve A.H, V.B dhe A.M, lidhur me ekzistimin e veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4,të KPRK dhe veprës penale të Mashtrimit në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, lidhur me faktet dhe rrethanat për ekzistimin e veprave penale , kjo për arsye se sipas vlerësimit të Gjykatë së Apelit, elementi thelbësor për ekzistimin e veprave penale duhet të ekzistojë qëllimi që të akuzuarit A.H dhe V.B, të përfitojnë dobi pasurore për veti, gjë që me ekspertizë nuk është vërtetuar, ose ti mundësojnë personit tjetër të përfitoj dobi pasurore këtu të akuzuarit A.M, e i cili sipas ekspertizës së ekspertit financiar i akuzuari A.M i ka mbuluar shpenzimet në vlerë prej 94.128,87 Euro.

Gjykata e shkallës së parë, nuk jep asnjë arsye se në cilat forma si persona zyrtar të akuzuarit A.H dhe V.B, në MKRS, a i kanë shfrytëzuar pozitat e tyre zyrtare apo autoritetin zyrtar, me tejkalimin e kompetencave të tyre zyrtare, ose në mos përmbushjen e detyrave të tyre zyrtare, gjë që në çështjen penale konkrete gjykata e shkallës së parë nuk jep ndonjë fakt vendimtar se a ka ekzistuar qëllimi (dashja), e të akuzuarve për kryerjen e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë, dhe gjykata pa vlerësimin e provave e në prezencën e ekspertizës financiare dhe të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr.13/2011 të dt.28.02.2012, i cili aktgjykim nga Gjykata Supreme e Kosovës, sipas revizionit është hedhe si e pathemeltë, e të cilat gjendjen në shkresat e lëndës, të paditurit “Morina Films”, pronë e të cilit është kompania i akuzuarit A.M është detyruar që t’ia kthej MKRS shumën e alokuar të hollave për subvencionimin e filmit “...”, e lidhur me këto fakte si dhe me deponimet e dëshmitarëve, Ch.J, A.T, S.M, E. Sh, Z. H, K.B dhe F.B, gjykata vetëm përshkruan deklaratat e tyre pa dhënë asnjë vlerësim se të akuzuarit A.H, V.B, në cilësinë e personave zyrtar kanë nënshkruar kontratën dhe aneks kontratën me kompaninë “Morina Films”, për realizimin e filmit “...”, film i metrazhit të gjatë, e me përkrahjen edhe të Qeveris së Kosovës, ministrisë MKRS, e me të cilat janë lidhur kontrata dhe aneks kontrata.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nga ajo që u cek më lartë rezulton që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të jetë përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës

penale, edhe për pjesën gjykuese edhe për pjesën liruese e në bazë të nenit 384 par.1 nën par. 1.12 e në lidhje me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPP, e kjo për arsye se aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 365 par.1, të KPP, dhe nuk është bazuar se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin duhet ta bazoj në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor e me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë një nga një, e në bazë të vlerësimit të provave të nxjerr përfundime të qarta dhe konkrete lidhur me faktet vendimtare e siç është paraparë si në dispozitivin e nenit 361 par.1 dhe 2 të KPP.

Gjykata e Apelit, nuk procedoi sipas bazave tjera ankimore, për arsye se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 të KPP.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë, duhet ti evitoj shkeljet e sipër përmendura, që edhe një herë ti nxjerr të gjitha provat veç e veç, e sidomos të bëjë vlerësimin e ekspertizës së ekspertit financiar, bashkë me provat të cilat i ka paraqitur i akuzuari A.M, e me vlerësimin e aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C.nr,13/2011, të dt,28.02.2012, i cili sipas revizionit është hedhe poshtë nga Gjykata Supreme e Kosovës, të dëgjojë në cilësinë e dëshmitarëve ish kryeministrat B.K, dhe A.Ç, në rrethanat se filmi "...", a është përkrahur nga Qeveria e Kosovës, lidhur me subvencionimin e tij, dhe pas nxjerrjes së provave dhe vlerësimit të tyre të nxjerr përfundim të drejtë dhe ligjorë dhe të shikoj se në veprimet e të akuzuarve a formohen elementet e veprës penale, apo kemi raport civil-juridik, apo raport ekonomiko-juridik.

Gjykata e Apelit, duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP, e në kuptim të ekzistimit të ndonjë shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit A.H, e në bazë të nenit 385 par.1 nën par.1.3 të KPP, Gjykata e Apelit gjen se parashkrimi i ndjekjes penale ndaj të akuzuarit A.H për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, me të cilën dispozitë ligjorë është paraparë se kryesi i veprës penale dënohet me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet, dhe nga kjo rezulton se procedura penale sipas dispozitës së nenit 106 par.1 nën par. 1.4 të KPRK, i cili është i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, për veprat penale të dënueshme më shumë se 3 vjet burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret me kalimin e kohës 5 vjet, duke marr parasysh dispozitën e nenit 107 par.1 të KPRK, se afati i parashkrimit të ndjekjes fillon të rrjedhë nga dita kur është kryer vepra penale, sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata e Apelit, duke marr parasysh se vepra penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, është kryer me dt.27.02.2006, e gjer në vendosjen e kësaj çështje penale kanë kaluar 10 vjet, 3 muaj, e pesë ditë, e kjo nënkupton se kanë kaluar më shumë se 10 vite prej kohës së kryerjes së veprës penale, pra ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit të veprës penale, siç është rregulluar me dispozitën e nenit 107 par.8 të KPRK.

Në Gjykatën e Apelit, sipas procedurës ankimore lënda penale është pranuar me dt.27.04.2016, e nga kjo del se lënda sipas procedurës ankimore për vendosje në gjykatën e Apelit është pranuar dy muaj pasi që është parashkruar lënda në raport me të akuzuarin A.H, e për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 402 par.1 dhe 403 par.1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.256/2016 me dt.02.06.2016

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Kryetari i Kolegjit

Mejreme Memaj

Abdullah Ahmeti

